



Misioni në Kosovë

Misionit të OSBE-së në

Kosovë i është besuar roli

udhëheqës për çështjet që

kanë të bëjnë me ndërtim

institucional dhe të

demokracisë, me shtet ligjor

dhe me të drejta të njeriut

në rajon. Misioni e formon

kështu një komponentë të

veçantë apo "degë" të

Administratës së Përkohshme

të Misionit të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), dhe ndër të tjera

është përgjegjëse edhe për

trajnimin e administratorëve

të policisë, civil dhe ata

të drejtësisë; vazhdimin e

zhvillimit të shoqërisë civile;

përkrahjen e zhvillimit të

mediave; organizimin dhe

mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe

mbikqyrjen, mbrojtjen dhe

përparimin e të drejtave

të njeriut.



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Misioni në Kosovë

Qendra Juridike e Kosovës

Qendra Juridike e Kosovës (QJK) është themeluar nga OSBE-ja në qershor të vitit 2000. Qëllimi kryesor për krijimin e kësaj qendre ishte ngritja e aftësi profesionale dhe e talentit juridik vendor për të themeluar OJQ vendore, afatgjate e të pavarura, që përfaqësojnë, zhvillojnë dhe promovojnë parimet demokratike, multikulturore, etike si dhe sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Që nga themelimi, QJK-ja shërben si një organizatë hulumtuese ligjore e dedikuar për të realizuar këto parime.

Puna e QJK-së përcillet nga një bord i drejtorëve. Ata takohen çdo tre muaj. Bordi është i përbërë nga gjashtë anëtarë dhe ka përfaqësues të OSBE-së, Këshillit të Evropës, Unionit Evropian, Fondacionit Evropian për Shoqëri të Hapur, përfaqësuesve të pakicave dhe drejtorëve të QJK-së.



Hulumtimi dhe analiza

QJK-ja punëson avokatë të specializuar në çështjet civile, kriminale, administrim publik dhe të drejtat e njeriut. Këtu jepen komente për ligjet dhe rregulloret aplikuese vendore që kanë ekzistuar para dhe pas vitit 1989. Në këtë qendër hartohen komente dhe mendime lidhur me punën e planifikuar legislative dhe pajtueshmërinë e tyre me ligjet ndërkombëtare dhe vendore. Avokatët e QJK-së poashtu janë anëtarë të grupeve të ndryshme ndërkombëtare që mirren me çështje ligjore.

Hartimi i ligjeve aplikuese është një nga projektet më të rëndësishme të QJK-së meqë ekziston një problem lidhur me qasjen ndaj legjislacionit në fuqi. QJK-ja është duke përkthyer, publikuar dhe shpërndarë pjesë të rëndësishme të ligjit në fuqi. Në vitin 2000 kjo qendër ka publikuar tre përmbledhje, C.I (Kodi penal, procedura penale), C.II (siguria në trafik, ligji mbi familjen dhe rregulloret e gjyqit), C.III (pronësia). Kohëve të fundit, C.IV Vol.1 (ligji administrativ) është publikuar dhe qendra është në proces të publikimit të dy volumeve tjera dhe një pjese shtesë të C.IV. QJK-ja planifikon që të vazhdojë të hartojë kompilacione dhe çështje të tjera specifike ligjore.

Studimet Ligjore të Kosovës është gazetë e QJK-së. Ky publikim përfshin shkrime të avokatëve të QJK-së dhe ekspertëve të huaj për tema të ndryshme problematike si rastet në gjyq, rekomandime për libra juridike dhe materiale të tjera interesante. QJK-ja, gazetën e saj e ka publikuar për herë të parë në verë të vitit 2001. Aty përfshihen shkrime mbi dhunën familjare, aspektet ligjore të tranzicionit socioekonomik në Kosovë, përmbledhje të librave të rinj, përmbledhje të rasteve të gjyqit dhe materialeve të tjera. Botimi i dytë përfshin edhe nene të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjeve të tjera, përfaqësimin ligjor, çështjet gjinore dhe çështje të tjera të rëndësishme. Gazeta Studimet Ligjore të Kosovës është botuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Gjatë 2001, QJK-ja ka botuar një doracak mbi institucionet dhe procedurat ndërkombëtare të respektimit të drejtave të njeriut në të tre gjuhët.

Ndihma për reformat në fakultetin juridik

QJK-ja është përqëndruar në edukimin ligjor të gjeneratave të ardhshme. Mu për këtë, luan një rol të rëndësishëm në reformimin e trajnimeve ligjore të studentëve të fakultetit juridik.

Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: press@omik.org

Website: www.osce.org/kosovo

QJK-ja ka luajtur një rol të veçantë në ndryshimin e planprogramit (kurrikulës) sipas standardeve moderne (modelin e bolonjës) në fakultetin juridik të Universitetit të Prishtinës. Universiteti e ka pranuar këtë planprogram për vitin akademik 2001/2002. QJK-ja ka qenë aktive edhe në finalizimin e planprogramit për studimet juridike të bazuara në Deklaratën e Bolonjës. Ka zhvilluar një sistem të ri të vlerësimit dhe ka përmirësuar metodat e të mësuarit përmes krijimit të një të mësuarit të ndërsjellë me bashkëligjëruesit e huaj që ftohen të ligjërojnë në Fakultetin juridik.

Përveç kësaj, QJK-ja është duke mbajtur kurse praktike ligjore. Studentëve u është dhënë mundësia që të mbajnë kurse të administrimit publik, praktikës së ligjit civil dhe procedurave kriminale. Në administrimin publik, takimet janë mbajtur gjatë procesit vendimmarrës, mosmarrëveshjet administrative, seanca të simuluar të gjyqimit dhe çështje të tjera. Në lëminë e ligjit civil seancat janë përqëndruar në procedurat civile, familje, patundshmërinë dhe testamentin. Në ligjet penale janë përfshirë hetimet, rolin e prokurorit, çështjet e mbrojtjes dhe gjyqimet. Kurset janë mbajtur nga avokatët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ekspertët ndërkombëtarë përfshijnë përfaqësues nga OSBE-ja, Bashkësia Evropiane, Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve dhe avokatë nga QJK-ja. Ekspertët vendorë përbëhen nga: gjykatës që punojnë në Gjyqin Suprem, gjyqet e qarkut apo gjyqet komunale, gjykatës që kryejnë praktikën në komunitetin e Kosovës dhe avokatët që punojnë në QJK.

QJK-ja poashtu bashkëpunon me organizata të ndryshme për të fituar bursa për të dërguar studentë jashtë vendit me qëllim që të zgjerojnë njohuritë mbi ligjin. Në veçanti do të përfshihen persona që duan të specializojnë në ligjet publike ndërkombëtare (përfshirë këtu edhe të drejtat e njeriut), pronësinë apo ligjin kriminal. QJK-ja ka ndarë bursa për studentë në Prishtinë dhe kanë hartuar programe për shkëmbimin e studentëve me shkolla të tjera juridike në Vienë dhe Grac në Austri dhe Utrecht në Holandë.

Së fundi, qendra është duke renovuar bibliotekën e fakultetit me qëllim që materialet moderne dhe hulumtuese të mund t'u ofrojnë ndihmë mesimdhënësve gjatë procesit të të mësuarit. Përafërsisht, 1.000 tituj janë zgjedhur për t'u përfshirë në koleksionin referues. Ky koleksion është vënë në një katalog elektronik, është vlerësuar dhe tani është në dispozicion për studentë. Që prej rihapjes së bibliotekës në tetor të vitit 2001, QJK-ja ka vazhduar që të identifikoj dhe të fitoj libra modern dhe gazeta për të cilat biblioteka ka nevojë. Rindërtimi i bibliotekës është mbështetur financiarisht nga qeveria gjermane dhe zvicerane si dhe nga Shoqata e Avokatëve të Kosovës/Iniciativa Ligjore e Evropës Lindore Qendrore (SHAK/IILELQ).

Seminaret

QJK-ja përmes seminareve dhe kurseve promovon diskutime mbi tema të ndryshme në komunitetin ligjor.

Që nga themelimi, QJK-ja dhe partnerët e saj kanë mbajtur seminare mbi çështjet e pronësisë, transformimin e pronave shoqërore, trafikimin e femrave, zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve në çështjet familjare, rolin dhe statusin ligjor të mediave dhe mbrojtjen ligjore në Kosovën e paskonfliktit. Të gjitha seminare kanë pasur edhe publikime të prezantimeve dhe ese mbi temat e mbajtura.

QJK-ja, si pjesë e projektit të edukimit ligjor, ka përgatitur seminare për përfaqësuesit juridik mbi ligjet familjare, procedurat civile dhe kriminale, ligjet kriminale, ligjet administrative etj. Ky projekt ka për qëllim që vazhdimisht të ngrisë njohuritë profesionale të personave juridik për tema të caktuara. Projekti është realizuar përmes ligjeratave të shkurta publike (2-3 orë) të përcjella me

diskutime. Temat ligjore të ligjeratave dhe diskutimeve do të përcaktohen në bazë të anketave dhe varen nga fakti se sa ekspertë ka.

QJK-së i është dhënë mandati nga Departamenti i UNMIK-ut i Arsimit dhe Shkencave që të realizojë projektin e autorizimit (fuqizimit) ministror. Qëllimi i këtij projekti të financuar nga Banka Botërore është që të siguroj trajnime themelore dhe të specializuara për personelin e ri profesional të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Prej shkurtit të vitit 2002, anëtarët e ardhshëm vendorë të ministrisë mund të kënaqen me kurset në lëminë e ligjeve kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe ato të arsimit.

Biblioteka e Qendrës Juridike të Kosovës

Personat juridik në Kosovë kanë mungesë të burimeve serioze të informatave për shkak se bibliotekat janë të pajisura dobët apo nuk ekzistojnë fare. Mu për këtë shkak, krijimi i një biblioteke juridike ishte një nga prioritetet e qendrës. Momentalisht, biblioteka e QJK-së përmban afro 3.500 revista juridike nga vende të ndryshme perëndimore dhe të Evropës juglindore. Në këtë koleksion mbulohen të gjitha degët juridike, historitë juridike dhe shkencat politike si dhe publikimet nga Kombet e Bashkuara, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës. Biblioteka shërben si qendër për mbledhjen e ligjeve vendorë, dekreteve, rregulloreve, juridiksionit, neneve administrative dhe përkthimeve të tyre. Aty mund të gjeni edhe një laramani librash që kanë të bëjnë me rajonin. Biblioteka është hapur në prill të vitit 2001.

Trajnimi në çështjet ligjore dhe pjesëmarrja në grupet punuese ligjore

QJK-ja u ofron përvijën e vet grupeve ligjore të punës apo njësiteve të komunitetit ligjor të Kosovës sipas kërkesave. QJK-ja është anëtare e Këshillit të Përbashkët Këshilltar për Çështje Legjislative e cila është duke shqyrtuar draft rregulloret që janë në kompetencat legjislative të PSSP-së. Përveç kësaj, QJK-ja është edhe anëtare e Diversity Task Force, e cila është themeluar nga zyra e Kryeministrit për qeverisje të mirë, mundësi të barabarta dhe barazi gjinore.

Personeli

QJK-ja ka një personel të këshilltarëve vendorë ligjorë që punojnë me programin ndërkombëtarë koordinues të OSBE-së, me një skemë menaxhuese të ndarë në mes të drejtorëve vendorë të asistuar nga këshilltarë ndërkombëtarë. Përveç personelit ligjor, burimet e QJK-së kanë edhe një bibliotekë, asistent gjuhe dhe personelin teknik të zyrës.

Informata plotësuese për QJK-në mund të gjeni në website-in e kësaj qendre: www.kosvolawcentre.org

Korrik 2002

Informata kontaktuese

Qendra Juridike e Kosovës

Ulpiana nr.23, 38000 Prishtinë

Tel: 381 (0)38 549 978

Fax: 381 (0)38 540 979

E-mail: kosvolawcentre@klc.ipko.org

